

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Varfëria / *el-Fekr* / الْفَقْرُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ"

"O njerëz, ju jeni ata që keni nevojë për Allahun." (Faatir, 15)

Varfëria ose *fekr* është një emër për heqjen dorë nga perceptimi i pronësisë.¹
Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është varfëria e asketëve (zahidëve), e cila nënkupton:

- Të lash duart nga kjo botë; as të mos e mbash, as të mos e kërkosh.²

¹ Personi duhet të pranojë plotësisht se pronësia e tij është e varur dhe kalimtare, dhe atë se madje edhe shpirti i tij dhe veprat e tij janë pronë e Allahut. Varfëria këtu nuk ka të bëjë me mungesë parash, por me ndjesinë e një nevojë të skajshme për Allahun dhe varësinë nga Ai për të gjitha format e furnizimeve.

² Realizimi i këtij *zuhdi* bëhet duke iu shmangur lakmisë dhe grumbullimit (të pasurisë). Umeri ؓ që një nga zahidët më të mëdhenj në histori dhe njëherësh që i vyer e i aftë për punë. Gjysma nga dhjetë sahabët që morën sihariqin për pranimin e tyre në xhenet në një hadith, qenë tejet të pasur. Gjatë kohës së peygamberit ﷺ, të pasurve s'u shkactohej kompleksi i inferioritetit dhe nuk bëheshin të ndiheshin të ndyrë. Koprancia, lakmia, ekstravaganca, dhe grumbullimi i pasurisë qenë ato që dënoheshin asokohe, jo pasuria. Dijetarët kanë dalluar rreth asaj se a janë më të mirë të pasurit mirënjohës, apo të varfrit durimtarë. Ibn Tejmijes i që bërë kjo pyetje nga Ibn el-Kajjim dhe përgjigjja që: "Më të devotshmit (janë më të mirë)." Jahja ibn Mu'adh tha se pasuria dhe varfëria nuk do të vendosen në Peshoren e Ditës së Gjykimit; aty do të vendosen durimi dhe falënderimi. Njerëzit kanë rrethana dhe potenciale të ndryshme. Për disa pasuria (*ghina*) e shoqëruar me falënderim është më e mirë, sesa varfëria (*fekr*) e shoqëruar me durim (*sabr*); e kundërta mund të jetë e vërtetë për të tjerë. Për njeriun si Imam Ahmedi, i cili nuk deshi ta harxhonte kohën e vlefshme në fitimin e parave përtej nevojave themelore të tij dhe as nuk pranonte favore nga ndokush, duke njohur veten e vet se do të mund ta përballonte hirshëm varfërinë dhe mënyra e tillë e të jetuarit do t'i ndihmonte që ta arrinte potencialin e plotë që kishte, varfëria është më e vlefshme. Në anën tjetër, Ibn el-Mubarek dhe Ibn

- Të heshtësh lidhur me të; as të mos e lavdërosh, as të mos e përçmosh.³
- Të qëndrosh i sigurt prej saj; as të mos e dëshirosh, as të mos e braktisësh.⁴

Kjo është varfëria për vlerën e së cilës është folur.

Niveli i dytë është reflektimi për paraekzistencën (e Zotit) duke parë hirin (hyjnor). Kjo:

- Të bën të mos shohësh veprat e tua.⁵
- Të pengon që t'i shohësh gjendjet shpirtërore (*ahwaa*).
- Ta heqë ndyrësirën e të parit të stacioneve shpirtërore (*mekaamaat*).⁶

Niveli i tretë:

- Bindja për skamjen.⁷
- Dorëzimi në realizimin tëhuajtës të njësisë (së Zotit).⁸

el-Musejjeb qenë të pasur dhe pasuria e tyre ua mundësoi që t'ia kushtonin kohën mësimi dhe ta harxhonin në rrugën e Allahut. Ata, megjithëkëtë, qenë të varfër, meqë nuk pohonin pronësi për asgjë në mbretërinë e Tij dhe shprehnin varësi të plotë nga Ai për të gjitha nevojat e tyre.

³ Sikur vërtet të ishte e parëndësishëm për ty, nuk do të humbje kohë duke e përçmuar; pra ti as që do të preokupohe me të.

⁴ Kur të të mungojë, mos u shqetëso për të; kur ta kesh, përdore në rrugën e Tij. Mos e bëj shkallën e varfërisë qëllim të zemrës sate. Kënaqësia e Allahut duhet të jetë qëllimi kryesor për të cilin duhet të mundohesh në të gjitha gjendjet dhe rrethanat.

⁵ Kur të pranosh se edhe veprat e tua dhe shpirti yt janë krijesa të Tij. Të gjitha janë favore nga Ai.

⁶ Dallimi mes *haal* (gjendje) dhe *mekaam* (stacion) mund të jetë në atë se e para ka një natyrë më kalimtare ose është një dhuratë nga Allahu pa një ndjekje (kërkim) të saj nga ana e robit, ndryshe nga *mekaam* që mund të jetë një gjendje më e qëndrueshme e të qenët ose një që është dhuruar nga Zoti pasi është ndjekur (kërkuar) nga robi në mënyrë aktive. Të pranosh paraekzistencën e Allahut nuk do të të bëjë ta mohosh pronësinë e objekteve materiale ose vetëm veprat e tua të mira; kjo do të të bëjë të mohosh çfarëdo merite për ndonjë gjë, përfshirë dhe gjendjet shpirtërore që ti përjeton.

⁷ Mungesën e çfarëdo mjeti të jetesës pa hirin e Zotit.

⁸ Ta lejosh vetveten të shkëputesh nga bota e të fundmeve dhe imazheve dhe të tërhiqesh drejt të Vetmit, të Vërtetit, shkakut të parë e të fundit, të Përrjetshmit pa fillim a fund.

- Tërheqja e përhershme në fushat e gjera dhe të shkreta të abstraksionit.⁹

Kjo është varfëria e sufive.

⁹ Ta shohësh të Parin ﷺ të ndarë nga të gjitha gjërat që kanë fund dhe fillim (*hawadith*). Është e shkretë, sepse të gjitha të tjerat (*siwa*) do të mbeten mbrapa dhe do të zhduken nga perceptimi yt. Është e gjerë, sepse është çlirimi përfundimtar nga kufizimet e të parët e 'të tjerave' (*shuhuud es-siwa*), gjë që i referohet heqjes së vëmendjes duke shikuar shumësinë e gjërave të krijuara dhe dukuritë në univers.